



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
RADIO TELEVISIONI SHQIPTAR

NJOFTIM

Radio Televizioni Shqiptar njofton të gjithë të interesuarit, aplikues për vendin e lirë të punës, të plotësojnë dhe depozitojnë dokumentacionin si më poshtë:

1. Formularin e aplikimit për punësim ([kliko këtu](#))
2. Formularin e vetëdeklarimit ([FORMULAR VETËDEKLARIMI](#))
3. Jetëshkrim në gjuhën shqipe;
4. Fotokopje e kartës së identitetit(ID);
5. Referenca.

Dokumentacioni duhet të depozitohet pranë zyrës së Protokollit të RTSH-së ose aplikimit elektronik në adresën info@rtsh.al deri më 20 Shtator 2026.

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatëve.

1 vend pune në pozicionin:

“Kryeinxhinier” në Sektorin Teknik, në Qendrën Vendore Audiovizive Korçë

Kandidatët që aplikojnë për pozicionin “Kryeinxhinier” në Sektorin Teknik, në Qendrën Vendore Audiovizive Korçë të plotësojnë kërkesat e përgjithshme si dhe kërkesat e veçanta të vendit të punës si më poshtë:

1.Kërkesat e përgjithshme të vendit të punës:

- 1.1 Të jetë shtetas shqiptar;
- 1.2 Të mos jenë të dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë.

2. Kërkesat e veçanta të vendit të punës:

- 2.1 Të ketë mbaruar arsimin e lartë (inxhinieri elektrike, elektronike, ose IT).
- 2.2 Të jetë njohës i mirë i skemave elektronike dhe elektrike dhe të njohë shumë mirë pajisjet dhe parimet e transmetimit dhe regjistrimit.
- 2.3 Të ketë njohuri në fushën e transmetimit radio-televiziv, të sinjaleve, aparaturave.
- 2.4 Të njohë shumë mirë të gjithë llojet e aparaturave në studiot e radios dhe tv.
- 2.5 Të ketë aftësi organizative dhe komunikuese.
- 2.6 Të ketë përvojë pune në profesion jo më pak se 5 vjet.